



REPUBLIKA E SHQIPË RISË

**BASHKIA PATOS**  
**SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Patos, më 04/11/2024

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale për sinjalistikën rrugore”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

- Materiale sinjalistike 34928471-0,
- Sinjalistikë rrugore 34992200-9

**VLERA E FONDIT LIMIT:** 1,245,250 (një milion e dyqind e dyzet e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, venë në dispozicion nga të ardhurat lokale 2024, për objektin: **“Blerje bazë materiale për sinjalistikën rruogre”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatesisht **498,100 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëqind) Lekë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$\underline{1,245,250 \times 40\% = 498,100 \text{ Lekë.}}$$

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2024.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzoj vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim:* Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

*Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2023 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi*

kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate përkatësisht **249,050 (dyqind dyzetë e nëntë mijë e pesëdhjetë) Lekë.**

*(apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot).*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

**1245250 x 20% = 249,050 Lekë.**

---

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

**2.3.2.** Operatori ekonomik duhet të ofrojë garanci 1 (një) vjeçare për produktet e ofertuara nga momenti i marrjes në dorëzim, përveç zëri numër 14 “Tra digital për parkim me komandim me pult” garancia e të cilit do të jetë 2 (dy) vjet, si dhe ndërrimin në raste difektesh nëpërmjet një deklarate për periudhën e garancisë, gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë edhe riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

**2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të deklarojë nëpërmjet paraqitjes së një deklarate se merr përsipër të realizojë furnizimin e mallrave objekt prokurimi (përfshirë kryerjen e shërbimit të transportit të të gjithë artikujve në ambjentet e Autoritetit Kontraktor, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe brenda afatit kohor të përcaktuar nga AK me kostot e veta.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.4.** Operatori ekonomik duhet të paraqesi Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mëposhtëme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

14	treg	Tra digital për parkim me komadim me pult	Copë	1
----	------	---	------	---

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter kërkohet për ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

**2.3.5.** Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 15/11/2024 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë:

Nr.		Emërtimi materialeve	Njësia	Sasia
1	treg	Barriera rrugore materiali HDPE i qëndrueshëm $\geq L:207\text{cm} \times \geq D100\text{CM}$ , trashësia 55mm të mos përcoj rrymën elektrike, me këmbë të qëndrueshme	Copë	1
3	treg	Kufizues shpejtësie 500x350x50mm	Copë	1
4	treg	Dritë sinjalizuese për barrierat rrugore me panel diellor	Copë	1
5	treg	Shkop sinjalizues me llamp ndricues për rregullimin e trafikut	Copë	1
6	treg	Tabela sinjalizuese për ndryshimin e sensit të drejtimit. Me llampa led me panel diellor	Copë	1
7	treg	Mbyllës anesor për kufiues shpejtësie	Copë	1
14	treg	Tra digital për parkim me komadim me pult	Copë	1

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë e mallrave ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

**Shënim:** Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Duke qën se pajisjet janë specifike dhe përdorimi i tyre është shumë profesional është e nevojshme sjella e mostrave për të vërtetuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e pajisjeve me procesin e punës.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar në të cilën është e përcaktuar se: 6 Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.<sup>38</sup> Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

### **Specifikime teknike:**

#### **Barriera rrugore materiali HDPE**

Dimensionet:  $L \geq 207$  cm,  $X \geq D100$ CM, Trashësia  $\geq 55$ cm

Materiali: HDPE i qëndrueshëm

Rezistent ndaj rrezeve UV, spërkatjeve me kripë, temperaturave të ulëta dhe të larta

Rezistente ndaj ndryshkut dhe lahet

Këmbë të qëndrueshme

Ngjyra: e kuqe/portokalli/e bardhë

Nuk përçon rrymën elektrike

#### **Kufizues shpetjesie 500x350x50mm**

Materiali: Gomine e forte dhe shumë rezistentë ndaj peshës së automjeteve

Përmasa: 500mmx350mmx50mm

Ngjyra: e verdhë dhe e zezë

#### **Mbyllës anësor për kufizues shpejtësie**

Materiali: Gomine e forte dhe shumë rezistentë ndaj peshës së automjeteve

Përmasa: 250mmX350mmX50mm

Ngjyra: e verdhë dhe e zezë

## **Dritë sinjalizuese për barrierat rrugore me panel diellor**

Drita paralajmëruese e barrikadës diellore: lente PS dhe bazë PP

Lentet dhe ngjyra bazë: e verdhë, portokalli, e kuqe, blu, jeshile, blu, etj.

Përmasat: 270--285mm\* 160-- 180mm\*80--90mm

Burimi i dritës: 2 copë LED

Ngjyra LED: E verdhë

Modaliteti i punës: Ndezje me frekuencë

Bateria: Bateri e rikarikueshme 2.4V

Sensori i dritës: Të ndizet dhe kryejë funksionin automatikisht gjatë natës

Fiksimi në barrierën rrugore: Me mbajtëse metalike

## **Shkop me ngjyra me llamp ndricuese për rregullimin e trafikut**

Burimi i dritës: Bateri e thatë ose e rikarikueshme

Ngjyra: e kuqe (floureshente)/ jeshile (floureshente)/ e verdhë (floureshente)

Materiali: ABS+PC

Ndricimi: LED, me disa opsione të ndricimit (ndricim konstant, ndezje dhe fikje blic, ndricim paralajmërues)

Përmasat: Gjatësia 38cm-40cm, gjerësia 3cm-4cm

Tabelë led me panel diellor për rregullimin e trafikut

## **Tabela sinjalizuese për ndryshimin e sensit të drejtimit. Me llampa led me panel diellor.**

Furnizimi me energji: Me panel diellor

Përmasa 1400mmx400mm

Ndriçimi: Led

Materiali: Alumin + PC

## **Tra digital për parking me komandim me pult**

Madhësia: 355\*249\*1035mm

Gjatësia e krahut: 6 m maksimumi, i rregullueshëm

Lartësia nga toka: 890 mm

Lloji i krahut: i drejtë, i palosshëm, i rrethuar, teleskopik

Distanca në distancë: brenda 30 m

Koha e ngritjes: 3s / 6s

Tensioni: AC220V 10% 50Hz

Fuqia e motorit: ≥90 W

Transformator: 24V

Vlerësimi IP i Mbrotja: 54

Garancia: 2 (dy) vjet

## **Shirit kufizimi e verdhë-e zezë (75mmx500m)**

Gjërësia:  $\geq 7.5$  cm

Materiali: PVC

Gjatësia:  $\geq 500$ m

Ngjyra: e bardhë/kuqe

## **Rjeta kufizuese lartësia 1m, gjatësia 50m**

Lartësia: 1 m

Gjatësia: 50 m

Materiali: Plastik

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **Drejtoria e planifikimit dhe zhvillimit të territorit**, me shkresën me nr. 3778/2 datë 10.10.2024 nga drejtori Ing. Boreta Murati e cial është në cilësinë e specialistit të fushës për këtë objekt, duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **15/11/2024, ora 09:00**.

**I.** Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje bazë matriale për sinjalistikën rrugore”**.

**II.** Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

**Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit.

### **NJESIA E PROKURIMIT**

**Florian Kita**

**Boreta Murati**

**Mitjon Nikolla**